

MARRËVESHJE

NDËRMJET

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË FRANCËS

DHE

**KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

LIDHUR ME BASHKËPRODHIMIN KINEMATOGRAFIK

Qeveria e Republikës së Francës dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në vijim të referuara si “Palët”,

Duke njohur nevojën për të forcuar bashkëpunimin kulturor midis Francës dhe Shqipërisë, veçanërisht duke inkurajuar, në përputhje me detyrimet e tyre ndërkombëtare, zhvillimin e bashkëprodhimeve kinematografike,

Të vetëdijshëm se bashkëprodhimet kinematografike kanë natyrën të nxisin krijimtarinë kinematografike në të gjithë diversitetin e saj dhe zhvillimin e industrisë kinematografike në Francë dhe Shqipëri,

Duke rënë dakord që bashkëprodhimet dypalëshe të filmit kontribuojnë në diversitetin kulturor dhe edukimin mbi imazhin,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Kreu I – Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1 – Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi "vepër kinematografike" nënkupton një vepër kinematografike, pavarësisht nga zhanri i saj (fiksion, animacion, dokumentar), kohëzgjatja, procesi i fiksimit dhe mediumi, i prodhuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore të secilës prej Palëve dhe shfaqja e parë e të cilës kryhet në një sallë shfaqjesh kinematografike;
2. Termi "bashkëproducent" nënkupton një kompani prodhimi të krijuar në territorin e njëres prej Palëve dhe që plotëson kushtet e parashikuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore të asaj Pale;
3. Termi “bashkëprodhim kinematografik” nënkupton lidhjen ndërmjet të paktën dy bashkë producentëve, së bashku me burimet e siguruara nga secili prej tyre, me synimin për realizimin e përbashkët të një veprë kinematografike;
4. Termi “autoritet kompetent i Palëve” nënkupton:
 - a) Për Qeverinë e Republikës Franceze: Qendra Kombëtare për Kinemanë dhe Imazhin në Lëvizje;
 - b) Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë: Qendra Kombëtare e Kinematografisë.

Neni 2 – Qëllimi

Kjo Marrëveshje rregullon marrëdhëniet midis Palëve në lidhje me bashkëprodhimet kinematografike me qëllim inkurajimin dhe lehtësimin e bashkëprodhimit të veprave kinematografike midis bashkëproducentëve nga secila prej Palëve.

Kreu II – Kushtet për të përfituar nga marrëveshja e bashkëprodhimit

Neni 3 – Kushtet e përgjithshme

Pranimi i një vepre kinematografike në zbatim të kësaj marrëveshjeje varet nga respektimi nga bashkeproducentët i kushteve të parashikuara për këtë qëllim nga dispozitat ligjore dhe nënligjore të secilës prej Palëve dhe nga përcaktimet e kësaj marrëveshjeje.

Neni 4 – Kushtet në lidhje me bashkë producentët

Për të përfituar nga kjo marrëveshjeje, vepra kinematografike duhet të jetë bashkëprodhim nga të paktën një bashkëproducent i vendosur në territorin e secilës prej Palëve.

Rast pas rasti, autoritetet kompetente të Palëve, me marrëveshje të përbashkët, mund të pranojnë që një vepër kinematografike për të cilën kërkohet përfitimi nga kjo marrëveshjeje, të ketë një ose më shumë producentë nga shtetet me të cilat njëra ose tjetra Palë është e lidhur me një marrëveshje tjetër bashkëprodhimi kinematografik.

Neni 5 – Kushtet në lidhje me kontratën e bashkëprodhimit

Për atë që e përcakton në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore të secilës palë, kontrata e bashkëprodhimit i garanton secilit bashkëproducent bashkëpronësinë e elementeve të prekshme dhe të paprekshme të veprës kinematografike.

Kontrata e bashkëprodhimit parashikon shpërndarjen e të ardhurave nga shfrytëzimi i veprës kinematografike. Kjo shpërndarje përcaktohet lirisht nga bashkë producentët me kusht që shpërndarja e përcaktuar të jete në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore të secilës palë.

Kontrata e bashkëprodhimit parashikon që origjinali i veprës së bashkëprodhimit të depozitohet në një vend të zgjedhur me marrëveshje të përbashkët nga bashkë producentët dhe kjo qasje të garantohet për çdo bashkë producent në përputhje me kushtet dhe kufizimet e parashikuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore të secilës prej Palëve.

Kontrata e bashkëprodhimit i garanton çdo bashkëproducenti qasje në çdo origjinal që lejon riprodhimin e veprës kinematografike me qëllim shfrytëzimin e saj, në përputhje me kushtet dhe kufizimet e parashikuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore të secilës prej Palëve.

Neni 6 – Kushtet në lidhje me kontributet nga bashkë- producentët

Përqindja e kontributeve përkatëse të bashkëproducentëve të secilës palë mund të shkojnë nga 20% në 80% të buxhetit total të bashkëprodhimit.

Autoritetet kompetente të Palëve, me marrëveshje reciproke, mund të lejojnë përjashtimisht që shumën e kontributit të reduktohet në 10% të buxhetit total të bashkëprodhimit.

Neni 7 – Kushtet në lidhje me pjesëmarrjen artistike dhe teknike

Kontributi i secilit prej bashke-producentëve duhet të përfshijë pjesëmarrjen efektive artistike dhe teknike. Kjo pjesëmarrje, në parim, duhet të jetë proporcionale me investimin financiar të secilit prej bashke-producentëve.

Kushtet në lidhje me kombësinë ose vendbanimin e autorëve, artistëve interpretues dhe teknikëve bashkëpunëtorë krijues që kontribuojnë në prodhimin e veprës kinematografike, si dhe kushtet në lidhje me vendin e krijimit të industrive teknike të përdorura për prodhimin dhe postprodhimin e veprës kinematografike, janë ato të përcaktuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore të secilës Palë në respekt të detyrimeve të tyre ndërkombëtare.

Kreu III – Procedura e pranimit në zbatim të marrëveshjes së bashkëprodhimit

Neni 8 – Kërkesë për pranim

Kërkesa për pranimin e një vepre kinematografike në zbatim të kësaj marrëveshjeje i nënshtrohet procedurave të parashikuara për këtë qëllim nga dispozitat ligjore dhe nënligjore të secilës prej Palëve.

Për më tepër, bashkëproducentët nga secila palë duhet, përpara fillimit të xhirimeve, t'i paraqesin autoritetit kompetent të Palës së cilës i përkasin, një dosje që përfshin:

1. Një kopje e kontratave që vërtetojnë zinxhirin e plotë të drejtave të autorit;
2. Informacion mbi kontributet teknike dhe artistike të bashkëproducentëve;
3. Një preventiv të detajuar dhe plan financimi;
4. Kontrata e nënshkruar e bashkëprodhimit.

Neni 9 – Miratimi i pranimit

Pranimi i një vepre kinematografike në zbatim të kësaj marrëveshjeje miratohet, përkohësisht përpara fillimit të xhirimeve dhe përfundimisht pas përfundimit të veprës nga autoriteti kompetent i secilës prej Palëve, sipas procedurave të parashikuara për këtë qëllim nga dispozitat e tyre ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Autoriteti kompetent i Palës, bashke-producenti i të cilës jep kontributin e paket, jep miratimin e tij vetëm pasi të ketë marrë mendimin e autoritetit kompetent të palës, bashkeproducenti i të cilës jep kontributin më të madh.

Autoritetet kompetente të Palëve do t'i komunikojnë njëra-tjetrës të gjithë informacionin në lidhje me miratimin, modifikimin ose tërheqjen e një kërkesë për pranimin e një vepre kinematografike në zbatim të marrëveshjes së bashkëprodhimit.

Në rast të refuzimit të një kërkesë për pranimin e një vepre kinematografike në zbatim të marrëveshjes së bashkëprodhimit, autoritetet kompetente të Palëve do të konsultohen me njëra-tjetrën përpara këtij refuzimi.

Kreu IV – Efektet e pranimit në zbatim të marrëveshjes së bashkëprodhimit

Neni 10 – Dhënia e statusit të bashkëprodhimit kinematografik

Kur vepra kinematografike pranohet në zbatim të kësaj marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve do t'i japin asaj statusin e bashkëprodhimit kinematografik.

Kur autoritetet kompetente të Palëve i kanë dhënë veprës kinematografike statusin e bashkëprodhimit kinematografik, ky status nuk mund të tërhiqet më pas, përveçse me vendim të përbashkët të autoriteteve kompetente të Palëve.

Neni 11 – Kombësia e veprës kinematografike

Vepra kinematografike që ka statusin e bashkëprodhimit kinematografik konsiderohet nga secila palë si vepër kinematografike kombëtare.

Neni 12 – Përfitimet e dhëna

Si për prodhimin ashtu edhe për shfrytëzimin e saj, vepra kinematografike që ka statusin e bashkëprodhimit kinematografik përfiton automatikisht nga të njëjtat avantazhe si veprat kinematografike të realizuara në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore të secilës prej Palëve.

Përfitimet nga të cilat përfiton vepra kinematografike i jepen çdo bashkëproducenti nga Pala në territorin e së cilës është vendosur ky i fundit sipas kushteve të parashikuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore të asaj Pale. Këto përfitime fitohen vetëm nga bashkëproducenti i vendosur në territorin e Palës që i jep ato.

Neni 13 – Lehtësirat administrative

Palët do të lehtësojnë, në përputhje me rregullat e tyre kombëtare dhe angazhimet e tyre përkatëse ndërkombëtare, importin dhe eksportin e pajisjeve të nevojshme për një bashkëprodhim kinematografik.

Çdo Palë do të përpiqet, në përputhje me rregullat dhe angazhimet e sipërpërmendura, të lehtësojë lëvizjen dhe qëndrimin në territorin e vendit të saj të personelit artistik dhe teknik që bashkëpunon në bashkëprodhimin kinematografik.

Neni 14 – Prezantimi i bashkëprodhimit

Vepra kinematografike e pranuar sipas kësaj marrëveshje paraqitet, sipas rastit, me shënimin “bashkëprodhim franko-shqiptar” ose “bashkëprodhim shqiptaro-francez”.

Ky shënim figuron në titujt dhe në materialin promovues të veprës kinematografike.

Kreu V – Zbatimi i marrëveshjes së koproduksionit

Neni 15 – Komision i përbashkët

Për të shqyrtuar zbatimin e kësaj marrëveshjeje, do të krijohet një komision i përbashkët, i përbërë nga një numër i barabartë përfaqësuesish të autoriteteve kompetente dhe ekspertë të caktuar nga secila prej dy Palëve.

Komisioni i përbashkët mblidhet në parim çdo pesë (5) vjet, në mënyrë alternative në Francë dhe Shqipëri.

Komiteti i përbashkët mund të mbledhet gjithashtu me kërkesë të një prej autoriteteve kompetente, veçanërisht në rast të modifikimit të dispozitave ligjore dhe nënligjore kombëtare në lidhje me kinematografinë ose në rast se marrëveshja has në vështirësi tepër serioze në zbatimin e saj, veçanërisht në rast të një çekuilibri midis kontributeve.

Neni 16 – Ekuilibri i përgjithshëm i shkëmbimeve

Autoritetet kompetente të Palëve do të sigurojnë rregullisht ekuilibrin e përgjithshëm të shkëmbimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

Për sa i përket kontributeve të bashkëprodhimit, ky ekuilibër duhet të realizohet si për kontributet artistike dhe teknike, ashtu edhe për kontributet financiare të bashke-producentëve.

Ky ekuilibër është objekt i një përmbledhjeje të krijuar nga autoritetet kompetente të Palëve dhe shqyrtohet nga komisioni i përbashkët.

Në rast se vihet re një çekuilibër, autoritetet kompetente të Palëve do të studiojnë mjetet e nevojshme për të rivendosur ekuilibrin dhe do të marrin të gjitha masat që ata i konsiderojnë të nevojshme për këtë qëllim.

Neni 17 – Shkëmbimet e informacionit

Autoriteti kompetent i secilës Palë vë në dispozicion të autoritetit kompetent të Palës tjetër listën e dispozitave ligjore dhe nënligjore në lidhje me avantazhet e dhëna nga të dyja Palët.

Kapitulli VI – Dispozitat përfundimtare

Neni 18 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet konsultimeve ose negociatave ndërmjet Palëve.

Neni 19 – Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hy në fuqi tridhjetë ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me rrugë diplomatike, me të cilën Palët informojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Neni 20- Ndryshimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë, me marrëveshje të përbashkët midis Palëve, me shkrim. Ndryshimet bëhen pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje. Secila Palë i njofton Palës tjetër, me shkrim, përfundimin e procedurave të saj të brendshme të nevojshme që ndryshimet të hyjnë në fuqi. Ndryshimet hyjnë në fuqi ditën e parë të muajit pasardhës të datës së marrjes së njoftimit të dytë dhe bëhen pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

Neni 21 – Përfundimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje lidhet për një afat të papërcaktuar. Marrëveshja mbetet në fuqi deri në momentin kur zgjidhet nga njëra nga Palët. Secila nga të dyja Palët mund ta përfundojë atë, në çdo kohë, me njoftim me shkrim të dërguar me rrugë diplomatike. Në këtë rast, marrëveshja pushon së qeni e vlefshme gjashtë (6) muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi. Përfundimi i marrëveshjes nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me projektet e ndërmarra sipas kësaj marrëveshjeje, përveç nëse vendoset ndryshe nga palët.

Bërë në _____, me _____, në dy kopje origjinale, në shqip dhe frëngjisht, të dy tekstet janë të barasvlershme.

**Për Qeverinë e Republikës
së Francës**

**Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë**